

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



**GJUHË ANGLEZE**

**PROGRAMI  
MËSIMOR**

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin e punës së organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe neni 25 paragrafi 2 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11 dhe 51/11), ministri i Arsimit dhe Shkencës lejoi Programin mësimor për gjuhë angleze për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçar.

# 1. HYRJE

PLënda gjuhë angleze si gjuhë e parë e huaj është përfshirë në Planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar në tri periudhat zhvilluese të arsimit fillor nëntëvjeçar duke filluar nga klasa e parë deri në mbarim të klasës së nëntë.

Përfshirja e lëndës në Planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar ka të bëjë me tendencat bashkëkohore në sistemin arsimor të më shumë vendeve të Unionit Evropian, ku mësimi të gjuhës së parë të huaj i përkushtohet vëmendje e posaçme. Njëherësh, me mësimin e gjuhës së parë të huaj fillohet nga moshë e re, dmth., nga viti i parë i arsimit fillor të detyrueshëm.

Mësimi bashkëkohor i gjuhëve të huaja për nxënësit prej 6 deri 14 vjeç përcakton qëllimin e gjerë të kuptimit për kompetencat e komunikimit gojor dhe me shkrim të gjuhës së huaj të zgjeruara me kompetencat e leximit dhe kompetencave sociokulturale dhe interkulturore. Mësimi i dedikohet nxënësit si subjekt i procesit mësimor, zhvillimit të tij kognitiv-afektiv-social, përkatësisht zhvillimit të pavarësisë së tij në mësim dhe arritja e strategjisë të mësimi si bazë e mësimi të përjetshëm.

Lënda gjuhë angleze në klasën e shtatë mësohet me tre (3) orë në javë, përkatësisht 108 orë në vit dhe ka statusin e lëndës së detyrueshme.

Bazë kalimtare për përgatitjen e Programit mësimor për klasën e VII (shtatë) në arsimin fillor nëntëvjeçar janë:

- dokumenti programor Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar (përmbytjet dhe organizimi i veprimtarisë edukative arsimore) prej vitit 2007 ;
- Korniza e përbashkët referuese për gjuhët (bazat teorike të mësimi bashkëkohor për gjuhët e huaja dhe nivelet e kompetencave për përdorimin komunikativ të gjuhës së huaj)<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup>Si orientim sa i përket nivelit të kompetencave gjuhësore të cilat nxënësit do të duhej ti arrijnë në fund të disa periudhave edukative-arsimore në arsimin fillor janë marrë parasysh kahet nga Korniza e përbashkët referuese Evropiane për gjuhët, të cilat dallojnë gjithsej gjashtë nivele të shfrytëzimit komunikues të gjuhës së huaj: Në lëmin e nivelit elementar ato janë nivelet A1 (Niveli përgatitor/Breakthrough) dhe A2 (niveli themelor/Waystage), në lëmin e përdorimit të pavarur të gjuhës të nivelit B1 (niveli kalimtar/Threshold) dhe B2 (niveli i pavarur/Vantage) dhe në lëmin të përdorimit kompetent të nivelit të gjuhës C1 (niveli i avancuar/Effective Operational Proficiency) dhe C2 (niveli më i lartë/Mastery).

Në kushte të mësimi të gjuhës angleze në Republikën e Maqedonisë nxënësit pas tri viteve të para të mësimi të gjuhës angleze (prej klasës I - III) mundën pjesërisht ta arrijnë nivelin A1 (niveli përgatitor), pas tri viteve vijuese të mësimi të gjuhës angleze (prej klasës së IV-VI ) mundën në tërësi ta arrijnë nivelin A1 (niveli përgatitor) dhe mundën pjesërisht ta arrijnë nivelin A2 (niveli themelor). Të arriturat e kompetencave në pajtim me nivelet e theksuara do të paraqitet përmes rezultateve të pritura në programin për klasën e nëntë.

## 2. QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËS PËR PERIUdhËN ZHVILLUESE (PREJ KLASËS VII DERI KLASËN E IX)

- Nxënësit të aftësohen me fond të caktuar të njësive leksikore për shërbimin receptiv dhe produktiv me gjuhën, në përputhje me periudhën e tyre zhvilluese;
- të zhvillohen aftësitë për dëgjim dhe kuptim global dhe të përzgjedhur të teksteve me tematikë të njohur dhe më pak të njohur;
- të zhvillohen aftësitë për shprehje gojore, në përputhje me moshën (periudhën zhvilluese) të nxënësve;
- të arrijnë fond të caktuar gjuhësor dhe sociogjuhësor të njohurive dhe aftësive të cilat do t'iu mundësojnë ta përdorin në situata më të ndryshme komunikative;
- nxënësit të aftësohen të lexojnë tekste të shkurta për identifikimin e informatave konkrete dhe globale;
- të aftësohen të shkruajnë tregime të shkurta të thjeshta (përbërje) me përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit;
- të vërejnë disa elemente nga kultura e vendeve ku gjuha mësohet edhe në përgjithësi në kulturat tjera, në përputhje me moshën e tyre (periudha zhvilluese).

## 3. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN E VII

Nxënësi/nxënësja:

- të aftësohet përmes dëgjimit dhe asaj vizuale të njohë fjalë të reja dhe rrëfime të shkurta ta kuptojë rëndësinë e tyre;
- të mund të riprodhojë dhe prodhojë fjalë dhe rrëfime të zakonshme gjuhësore;
- të mund të lexojë tekste të shkurta për identifikimin e informatave konkrete dhe globale;
- të aftësohet të shkruajë tregime të thjeshta gjuhësore dhe tekste të shkurta duke përdorë drejt shenjat e pikësimit;
- të mund të zhvillojë komunikim të rëndomtë në nivel të vokabularit të përvetësuar dhe me zbatimin e funksioneve gjuhësore të afërta me moshën e nxënësve;
- të fitojë njohuri për kulturat tjera.

## 4. QËLLIMET KONKRETE

Komponenti 1: NJËSITË LEKSIKORE <sup>2</sup>			
Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/nxënësja:  • ta kuptojë rëndësinë e njësave leksikore, ti riprodhojë dhe ti përdorë në situata përkatëse të bisedës.	Të rinjtë dhe përditshmëria e tyre	I want to become a film star but my dad doesn't like the idea.  We spend a lot of time playing computer games.	Aktivitete të llojit të ushtrimeve me dëgjimin e audio incizimeve ose bisedën e mësimdhënësit dhe riprodhimin e të dëgjuarës, ushtrime të llojit të bisedës rreth problemeve më të shpeshta të cilat i preokupojnë të rinjtë, siç janë problemet në shkollë, shtëpi, si dhe ndërmjet nxënësve.
	Tinejxherët dhe moda	I like wearing jeans and trainers	Aktivitete të llojit të ushtrimeve me dëgjimin e audio incizimeve ose bisedën e mësimdhënësit dhe riprodhimin e të dëgjuarës, realizim i punës hulumtuese (Internet, revista etj.), çka preferojnë më së shumti të veshin tinejxherët, zhvillimi i bisedës me temën e dhënë etj.
	Muzika dhe TV programet e mia më të preferuara	Tom likes pop music. My favourite type of music is jazz. Sarah likes TV serials. He likes sports programmes.	Aktivitete të llojit të ushtrimeve me dëgjimin e audio incizimeve ose bisedën e mësimdhënësit dhe riprodhimin e dëgjimit, diskutimi me temë: „What's your favourite type of programme?“, „What type of music do you like?“ etj.
	Lloje të kafshëve të rrezikuara	The panda lives in China. Some people kill dolphins just for sport.	Aktivitete të llojit të ushtrimeve me dëgjimin e audio incizimeve ose bisedën e mësimdhënësit dhe riprodhimin e të dëgjuarës, grumbullimi i të dhënave nga Interneti, revista etj.), cilat janë llojet e kafshëve të rrezikuara dhe si mund t'iu ndihmohet, përpilimi i broshurave me tematikë përkatëse etj.

<sup>2</sup>Gjatë përpilimit të materialit të ri leksikor duhet të vendosen më shumë se 7-8 njësi të reja leksikore në një orë mësimore. Materiali leksikor në mënyrë succesive zgjerohet dhe përsëritet.

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
	Pushimi shkollor	It is summer. They are making a sand castle on the beach. It is winter. We are making a snowman. Have a nice holiday!	Aktivitete të llojit të ushtrimeve gojore „Which is your favourite holiday and why?“, diskutim në temë: Pushimi; lojëra të llojit Quiz, Vocabulary squares, Guessing game etj.
	Udhëtimi, rishikimi, blerja	I visited Scotland last summer. There are lots of castles there. I bought some souvenirs, like traditional tartan items and traditional Scottish biscuits.	Aktivitete të llojit të ushtrimeve duke dëgjuar audio incizime dhe riprodhimin e të dëgjuarës, ushtrime të llojit të simulimit Shopping role-play, lojëra të llojit A very long sentence, Hangman etj.
	Festat	Happy New Year! Merry Christmas! Happy Easter! Happy Halloween! Happy Valentine's Day!....	Aktivitete të llojit të simulimit në situatë folëse me temë: festat, përpunimi i uresave për festa të caktuara, përpunimi i maskave, simulimi i shfaqjeve me rastin e festave reciproke, të shkruarit e poemave të zakonshme si: Simple poems, mësimi i vjershave me rimë JingleBells, Carnival Song, Fancy Dress Party, etj.

### Komponenti 2: STRUKTURAT GRAMATIKOREI<sup>3</sup>

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ta njohë, kuptojë dhe përdorë formën e foljes to be në kohën e kaluar (Past Simple Tense) në formë pozitive, pyetëse dhe negative;</li> </ul>	<p>Folja To be në kohën e kaluar në formë pozitive, pyetëse dhe negative</p>	<p>They were at the cinema last night. Were they at the cinema last night? They weren't at the cinema last night.</p>	<p>Aktivitetet dhe metodat të cilat i sugjerojmë mund të zbatohen në të gjitha përmbajtjet e theksuara në gramatikë në përputhje me kërkesat e mësimit të strukturave gramatikore. Aktivitetet të cilat sugjerohen për realizimin e përmbajtjeve nga gramatika janë këto:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dëgjimi i tregimit nga mësime nxënësi dhe reagimi jo-verbal i të njëjtës (mimikë, gjestikulim, TRP);</li> <li>• ushtrime të llojit të reagimit verbal të parashtrimit të pyetjes;</li> <li>• ushtrime me përdorimin e ilustrimeve, flesh kartelave dhe postereve;</li> <li>• përdorimi i realisë si mjet për realizimin e përmbajtjeve të caktuara në gramatikë;</li> <li>• luajtja në role dhe simulime të situatave të dhëna etj.;</li> <li>• aktivitete të llojit Grammar Chants;</li> </ul> <p>• aktivitete të llojit plotësimi i vendeve të zbrazta në fjali.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• drejtë të mund ti përdorë ndajfoljet në kohën e kaluar (Past Simple Tense);</li> </ul>	<p>Ndajfolje kohe (yesterday, last (month, week...) ago</p>	<p>Peter was at a concert yesterday. Sara was in London last month. They were at the zoo a year ago.</p>	

<sup>3</sup>Strukturat gramatikore asnjëherë nuk interpretohen në mënyrë eksplicite, por të njëjtat nxënësit i përvetësojnë në mënyrë globale në strukturat gjuhësore vazhduese.

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj
<ul style="list-style-type: none"> <li>të dijë ti përdorë dhe zbatojë drejt noun substitutes one/ones;</li> </ul>	Noun substitutes one/ones	I don't like this red skirt. Do you have a blue one? These jeans are expensive. Are there any cheaper ones?
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund drejtë ta përdorë formën e foljes modale must për të shprehur obligim;</li> </ul>	Folja must (forma pozitive)	This is horrible. You must eat. It is healthy.
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund drejtë ta përdorë formën e foljes modale mustn't për të shprehur ndalesë;</li> </ul>	Folja mustn't (forma negative)	You mustn't touch that!
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund drejtë ti përdorë format e foljes modale should/shouldn't për të dhënë këshilla;</li> </ul>	Folje modale should/shouldn't	You should listen to your parents. You shouldn't drink cold water!
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund ti kuptojë dhe drejtë ti zbatojë shprehjet për sasi (quantifiers);</li> </ul>	Shprehje sasive	Some, any, much, little, many, a few, a lot of
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund drejtë ta kuptojë dhe zbatojë formën për shkallëzimin e mbiemrave njërrrokëshe (er-est);</li> </ul>	Komparativi i mbiemrave njërrrokëshe	Higher than, the highest; Bigger than, the biggest.
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund ta njohë dhe drejtë ta përdorë formën pavetore në njëjës dhe shumës në kohën e kaluar;</li> </ul>	Forma pavetore në kohën e kaluar (njëjës dhe shumës)	There was a library in their town. There were a lot of shops on that street.
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund ta njohë formën e Past Simple Tense (forma pozitive) te foljet e rregullta;</li> </ul>	Past Simple Tense Folje të rregullta	played; worked.....
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund ta njohë formën pyetëse dhe negative të Past Simple Tense te foljet e rregullta;</li> </ul>	Forma pyetëse dhe negative e Past Simple Tense te foljet e rregullta	Did you play football? I didn't watch that movie.
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund drejtë ta kuptojë dhe zbatojë përdorimin e ndajfoljeve të mënyrës.</li> </ul>	Ndajfolje mënyre	difficult,easy,hard



### Komponenti 3: FUNKSIONET GJUHËSORE

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të mund të zhvillojë komunikim të rëndomtë në situata adekuate folëse me zbatimin e funksioneve gjuhësore të këtij niveli të mësimit të gjuhës, përkatësisht të përshtatura për moshën e tyre.</li> </ul>	Dhënia e mendimit për muzikë dhe TV programet e preferuar.	Rap is my favourite kind of music. I never watch horror films.	<p>Aktivitete të llojit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>lojë në çifte (dialog);</li> <li>punë në grupe;</li> <li>ushtrime të llojit të rrëfimit verbal sipas ilustrimeve dhe postereve të dhënë;</li> <li>ushtrim me përdorimin e mimikave, pantonimave dhe dramatizimeve;</li> <li>lojëra të ndryshme të llojit just a minute, taboo, pictionary, tic-tac-toe, domino, chain games, guessing games, memory games etj.</li> <li>ushtrime të llojit describe and draw, pyramid discussions, surveys, general knowledge questions.</li> </ul>
	Shprehje për veprimet në të kaluarën	He played football with his friends last Sunday.	
	Parashtrim pyetjesh për veprime të kaluara	Were you at home last night? Did you do your homework yesterday?	
	Dhënie këshillash	I always feel tired in the morning. You should go to bed earlier.	
	Emërtimi i gjësendeve shkollore në klasën e shtatë	Biology is my favourite subject. We have Biology twice a week. We learn about plants and animals.	
	Shprehje sasie	There are few apples on the table. There is a little Fanta in the bottle	
	Shprehje urdhërash dhe ndalesa	You must have a passport to travel to another country. You must stop at a stop sign.	
	Krahasimi njerëzsende	My brother is older than me. Maths is easier than English. Skopje is the biggest city in Macedonia.	
Shprehje ndjenjash	I am very sad today. She is very happy.		

	Përmbajtje	Shembuj	
	Befasi, frymëzim	Oh, I didn't know that! Oh, what a nice party! You look wonderful today.	
	Shprehje lutjesh	Could you help me with my homework, please? Can you repeat that, please?	

#### Komponenti 4: DËGJIM ME KUPTIM

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/nxënësja: • të mund ta kuptojë rëndësinë e njëjësive leksikore të parapara për këtë moshë;	Njëjësia leksikore	fashion, jeans, trainers, jazz, classical, quiz shows panda, tiger, dolphin souvenirs, souvenir shops Christmas, New Year, Halloween, Valentine's Day	Reagim joverbal i nxitjes gojore, ilustrime, postere, flesh kartela; lojëra të llojit Information gap, hangman, words from words, Guess the words; pesni (p.sh. We Wish You a Merry Christmas, Jingle Bells); etj.
• të mund të kuptojë shprehje të thjeshta të shkurta;	shprehje të thjeshta të shkurta	Mary spends a lot of time playing computer games. Tom likes wearing jeans and trainers He never misses quiz shows on TV. Koalas live in Australia. Have a nice holiday!	Ushtrime të llojit të reagimit adekuat të rrëfimeve të dëgjua (nga videoincizimet ose nga mësimdhënësi, p.sh.: lëvizja e trupit, mimika); reagim joverbal ndaj instruksioneve/ rrëfimit të mësimdhënësit etj.
• të mund të kuptojë tekste në mënyrë globale dhe përzgjedhëse.	Tekste të shkurta	My favourite TV programme is "The Simpsons". It's a cartoon comedy series about an American family called the Simpsons. I like it because it's funny and it makes me laugh. ...	Aktivitete të llojit të rumbullakimit të informatave konkrete (zgjedhje shumë gjymtyrësh) etj.

### Komponenti 5: TË FOLURIT

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• drejtë ti shqiptojë dhe në mënyrë përkatëse ti zbatojë njësitë leksikore në tregime të thjeshta të shkurta të parapara për këtë nivel të mësimit të gjuhës në kuadër të funksioneve të parapara gjuhësore dhe strukturave gramatikore;</li> </ul>	<p>Filmi i preferuar</p>	<p>What is your favourite film? My favourite film is "Titanic". Why do you like it? I like it because it is a love story of two young people...</p>	<p>Aktivitete të llojit verbal të prodhimit dhe riprodhimit të fjalive dëftore të zgjeruara përmes: luajtja në role (sipas mundësive të përcjella me lëvizje), pjesëmarrje në situata më të ndërlikuara të dialogut, shfaqjeve teatrore dhe përshkrimi i situatave të dhëna, shpjegimi i tregimeve si vërtetim apo pohim i përvetësimit të leksikut dhe strukturave.</p>
	<p>Muzika e preferuar</p>	<p>My favourite singer is Jeniffer Lopez. She's a great singer and an actress, too. She' got a lot of hit songs and one of my favourite is...</p>	
	<p>Festa (shkollore, kombëtare, fetare)</p>	<p>I spent my winter holiday in Mavrovo. There was a lot of snow. I was with my friends from school.</p>	
	<p>Udhëtime, rishikime, blerje</p>	<p>This summer we were in Struga. We visited a lot of interesting places. We were at ....</p>	
	<p>Shtëpi jo të zakonshme</p>	<p>What type of a house would you like to live in?  I would like to live in the house of future. There are a lot of rooms: three living-rooms, seven bedrooms, four bathrooms, etc.</p>	

### KOMPONENTI 6: LEXIM ME KUPTIM

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të mund të lexojë dhe të kuptojë informata sipas hartës së dhënë;</li> </ul>	Leximi i hartave	<p>The bank is on the left. The zoo is next to the park.</p>	Aktivitete të llojit të pyetjeve dhe përgjigjeve (punë në çifte), Guessing Game, plotësimi i vendeve të zbrazëta etj.
<ul style="list-style-type: none"> <li>të lexojë për të identifikuar informata konkrete në tekstin e dhënë;</li> </ul>	Informata konkrete në tekstin e dhënë	Jennifer Lopez is a pop singer and an actress. She had a concert last night and sang all her hit songs. There were 15.000,00 people at the concert. The concert lasted three hours.....	Aktivitete të llojit të leximit të teksteve nga revista dhe ngjashëm për identifikimin e aktiviteteve konkrete (ushtrime të llojit të zgjedhjes shumë gjymtyrëshe, T/F ushtrime etj.).
<ul style="list-style-type: none"> <li>të lexojë dhe të kuptojë në përgjithësi tekstet e shkurta.</li> </ul>	Tekste të shkurta		Ushtrime të llojit të leximit për kuptim të përgjithshëm përmes aktiviteteve të llojit të zgjedhjes shumë gjymtyrëshe, T/F ushtrime, Guessing game etj.

KOMPONENTI 7: TË SHKRUARIT

Qëllime	Përmbajtje	Shembuj	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të mund ta kuptojë termin fonemë/grafemë;</li> <li>• të shkruaj dhe të flasë drejtë dhe të përvetësojë fjalë në mënyrë vizuale;</li> <li>• të përgjigjet me shkrim në pyetjet për tekstin e lexuar;</li> <li>• të plotësojë formularë me të dhënat personale;</li> <li>• të shkruajë tregime (përbërje) të shkurta për kërkesë ose transmetim të të dhënave, ndjenjave dhe ideve personale.</li> </ul>	<p>Ortografia e fonemave</p> <p>Të shkruarit drejtë e fjalëve dhe fjalive sipas diktimit</p> <p>Pyetje dhe përgjigje</p> <p>Të shkruarit e të dhënave personale</p> <p>Përbërje të shkurta (porosi e shkurtë, Uresë, ftesë, letër, përshkrim i shkurtë etj.</p>	<p>Ortografia e të gjitha zanoreve, bashkëtingëlloreve dhe diftongjeve;</p> <p>I like Biology very much. I learn about animals and plants.</p> <p>Dear Sara, I wish you a very Merry Christmas and Happy New Year</p>	<p>Ushtrime të llojit të plotësimit të fjalëve me shkronja të përvjedhur (lojë e llojit Hangman); ushtrime duke shkruar emrin e vet; lojë e llojit përbërja e fjalëve të thjeshta me shkronja të dhëna me renditje jo të drejtë; të shkruarit e fjalëve me ilustrime të dhëna etj.; plotësimi i tekstit me fjalë të cilat mungojnë sipas udhëzimit për të shkruar fjali të shkurta; të shkruarit e fjalive dhe tekste shumë të shkurta sipas modelit me zëdiktimit; vënia e fjalëve në radhë të drejtë në një fjali etj.</p> <p>Të shkruarit e uresave, ftesave, panoramave, e-mail porosive;</p> <p>Plotësimi i formularit me të dhëna personale; pavarësisht dhe bashkërisht për të bërë tekste për fotografi dhe përpunimi i ditarit të klasës ose poster; përpunim në formë të pavarur i posterëve tematik etj.</p>

## KOMPONENTA 8: KULTURË

Përmbajtjet nga Kultura janë përfshirë në të gjitha komponentat e mësimin të gjuhës, përkatësisht nuk mësohen të izoluara si komponentë e posaçme.

Qëllimi është që të krijohet senzibilitet për vështrimin e dallimeve dhe ngjashmërive kulturologjike si bazë për zhvillimin e tolerancës dhe empati ndaj tjetrit dhe të ndryshmit (psh., përmes emrave, festave, modeleve të sjelljes kulturore, ushqimit, këngëve, lojërave, numëratoreve, modeleve komunikative, elementeve paragjuhësore etj.), Nxënësit njoftohen me pjesë nga historia e vendeve ku flitet gjuha angleze, qytetet e mëdha, monumentet dhe vendet e tyre kulturore. Organizimet e manifestimeve të vogla për manifestimin e ditës së falënderimit (Thanksgiving), Kërshëndellat, Apriliada, Kurban Bajram etj.

Qëllimi qëndron në atë që të arrihen kompetencat interkulturore për sjellje duke i pasur parasysh dallimet kulturore; krijimi i ndjenjës për vështrimin e dallimeve kulturore përmes mësimin, edukimit dhe socializimit të përmbajtjeve si bazë për zhvillimin e respektit ndaj njerëzve të tjerë dhe punëve të ndryshme. Në qasjen të përmbajtjeve dhe temave mësimore, si dhe atyre kulturore, edukative dhe sociologjike duhet pasur parasysh për sjelljen e kulturave të ndryshme, përpunimin e përmbajtjeve të cilat mundësojnë krahasimin dhe socializimin e kulturës maqedone, shqiptare me kulturat tjera.

## 5. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Në planifikimin e mësimin për klasën e VII janë marrë parasysh përmbajtjet e programeve mësimore të lëndëve tjera të cilat mësohen në klasën e VII, përkatësisht është respektuar parimi i lidhshmërisë ndërlëndore sa i përket qëllimeve dhe përmbajtjeve me theks të posaçëm të integritit të lidhshmërive me përmbajtjet nga gjuha amtare.

Mësimi i gjuhës angleze për nxënësit e kësaj moshe bazohet në mësimin multisenzorues (vizual, auditiv, taktil etj.) dhe mësimi holistik i cili përfshinë aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, përkatësisht mësimdhënësi do ti integrojë komponentët e ndryshme me çka gjuha do të mësohet në mënyrë funksionale.

Në pajtim me këto që u theksuan më lartë në gjuhën e huaj nuk mund të ndahen, përkatësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve në komponente të ndara.

Mësimi për këtë moshë të rritur orientohet në mësimin kognitiv me eksklucion të zmadhuar të strukturave gjuhësore me zbatim të qartë të strukturave gjuhësore në kontekst dhe gradualisht aplikimi i gramatikës së gjuhës. Në këtë periudhë përqendrohet të zhvillohen komunikimi gojor dhe me shkrim. Kjo nënkupton se i kushtohet vëmendje e posaçme të gjitha shkathtësive gjuhësore: dëgjimit, dhe leximit në kuadër të komponentit Të kuptuarit, e të folurit si nga aspekti i interaksionit gojor si dhe nga aspekti i prodhimit gojor, dmth., të të shkruarit.

### *Mjetet mësimore:*

- komplet nga sistemi i lejuar i nxënësit;
- pako material në dorëshkrim për mësimdhënësin (flesh-kartela, postere etj.);

- kasetofon/ kasete me këngë; kompjuter me softuer përkatës; CD-ROM, TV me DVD;
- burime tjera të mësimit në mjedisit të drejtpërdrejtë – gjësende në hapësirën ku mësohet gjuha angleze;
- qasje në Internet, softuer arsimor;
- revista për mësimdhënësin.

## 6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

### *Ndjekja e të arriturave të nxënësve*

Gjatë mësimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, grumbullohen treguesit për aktivitetet e tyre, motivimi për mësim, bashkëpunimi me të tjerët; etj., (vlerësimi formativ). Çdo aktivitet në orë ku nxënësit e tregojnë aktivitetin gjuhësor, qoftë në nivel receptiv, riprodhues ose prodhues, jep mundësi për vrojtimin e përparimit dhe vlerësimin e tij. Kjo nënkupton se evoluimi bëhet si pjesë integrale në vetë orën e mësimit, e jo si akt izolues. Është shumë me rëndësi gjatë procedurave të njohurive, si dhe vlerësimit të nxënësit, këto procedura të mos dallohen nga aktivitetet e zakonshme të orës, përkatësisht nxënësit nuk duhet të ndahen në veçanti nga grupi gjatë kontrollimit të reagimit gojor gjuhësor.

Me rëndësi është theks i veçantë të vihet në aspektet pozitive të përparimit të nxënësve, dmth., atë që nxënësi e di, e jo atë që nuk e di. Me rëndësi është çdo përparim të shpërblehet në mënyrë adekuate, sepse nxënësve të ri iu nevojitet informata kthyesë për suksesin e

arritur, që mund të jetë edhe lëvdatë me gojë ose reagim pozitiv i shprehur përmes gjesteve ose mimikës ose, e buzëqeshje nga mësimdhënësi, lule të vizatuar etj.

Vlerësimi i përparimit të nxënësve do të bëhet gjatë vitit shkollor me ç'rast mësimdhënësi ka obligim në fletore të veçantë në mënyrë të vazhdueshme të mbaj shënime për secilin nxënës e në veçanti për përparimin e tyre në pajtim me komponentët e gjuhës të parapara me programin mësimor për klasën e VII. Me qëllim që prindërve t'iu mundësohet mbikëqyrje në përparimin e fëmijëve të tyre dhe në procesin e tyre të mësimit ku preferohet të aplikohet Portfolio gjuhësore evropiane e cila kontribuon që nxënësit të zhvillohen si pjesëmarrës në procesin mësimor. Portfolio i shpie drejt kuptimit të mësimit si proces i arritjes së njohurive dhe shkathtësive në të cilat janë aktiv. Gjithashtu i nxisin në të menduarit për strategjitë e suksesshme të mësimit, për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive të arritura si dhe për dëshirat dhe planet individuale për përparim dhe mësim të gjuhës së huaj.

Në mbarim të klasës së VII nxënësit do të vlerësohen me nota numerike. Pasojat për nxënësin në rast të mossuksesit do të jenë në përputhje me rregullativën e përgjithshme për arsim fillor në Republikën e Maqedonisë.

## 7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E MËSIMIT

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në normativin për hapësirë sjellë nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Kushtet hapësinore dhe pajisja e nxënësve për realizim të suksesshëm të Programit mësimor për klasën e VII duhet të jenë në përputhje me normativin e përgjithshëm për pajisje për realizimin e programeve mësimore për klasën e VII.

Rekomandohet, për shkak të kontaktit më të lehtë vizual ndërmjet nxënësve, që të dëgjojë më mirë atë që flitet edhe nxënësi i fundit, të ketë pasqyrë të tërë klasës, bankat të jenë të radhitura në këtë mënyrë: më shumë banka të afuara njëra pran tjetrës, variante të ndryshme të shkronjës „U” si dhe përllogaritje dhe grupim të karrigeve sipas nevojës (gjatë dramatizimit).

Programi mësimor nga gjuha angleze për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçar, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit, e sollë ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 11-7852/2 më 20.12.2011

## 8. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

- Studime të kryera nga gjuha angleze dhe literatura- drejtimi mësimor, VII<sup>1</sup>.
- Studime të kryera nga gjuha angleze dhe letërsia, VII<sup>1</sup>.
- Studime të kryera dylëndore nga gjuha maqedonishte dhe angleze, VII<sup>1</sup>.
- Studime të kryera nga gjuha angleze dhe letërsia – drejtim tjetër dhe me përgatitje përkatëse pedagogjike, psikologjike dhe metodike të fakultetit përkatës, VII<sup>1</sup>.